

RELACION TEKNIK

*Rikonstruksioni i kabinave dhe
rrjetit TU me kabell ABC Fideri
Nr.4/10KV N/Stacioni Kucove
110/35/10 /6 KV*

RELACION TEKNIK MBI INVESTIMET E KALIMIT TE KABINAVE EKZISTUESE ME RRJETIN E RI ABC ne kabinat e Fiderit Nr.4 (10kV), N/Stacioni Kucove 110/35/10/6KV.

- **Analiza vjetore e humbjeve te DR Berat dhe Agjensite e saj ne baze Fidri/Nstacioni.**

Humbjet e energjise elektrike ne % ne Drejtorine Rajonale Berat per vitin 2020 ishin ne nivelin 17.1%

Per vitin 2019 ishin ne nivelin 20.34 %

Per vitin 2018 ishin ne nivelin 20.16 %

Me poshte po pasqyrojme nivelin e humbjeve ne % dhe ne kWh per Agjensite e Drejtorise Rajoanle Berat per periudhen 2018 – 2019 - 2020.

Humbjet e energjise ne rang Agjensie per vitin 2020

| AGJENSIA | Konsumi Fiderit kWh | Faturimi Fiderit kWh | Humbjet KWh | Humbjet % |
|--------------|---------------------|----------------------|-------------------|-------------|
| Berat | 113,959,000 | 93,951,019 | 20,009,507 | 17.6 |
| Kucove | 65,015,341 | 55,950,232 | 9,064,109 | 13. |
| Lushnje | 192,633,841 | 157,255,154 | 35,378,687 | 18.4 |
| Skrapar | 44,464,417 | 37,913,213 | 6,552,204 | 14.7 |
| Total | 416,071,125 | 345,069,618 | 71,003,507 | 17.1 |

Humbjet e energjise ne rang Agjensie per vitin 2019

| AGJENSIA | Konsumi Fiderit kWh | Faturimi Fiderit kWh | Humbjet KWh | Humbjet % |
|--------------|---------------------|----------------------|-------------------|--------------|
| Berat | 123,479,526 | 100,628,019 | 22,851,507 | 18.51 |
| Kucove | 45,826,341 | 37,619,232 | 8,207,109 | 17.91 |
| Lushnje | 164,271,841 | 128,583,154 | 35,688,687 | 21.73 |
| Skrapar | 23,912,417 | 17,961,213 | 5,951,204 | 24.89 |
| Total | 357,490,125 | 284,791,618 | 72,698,507 | 20.34 |

Humbjet e energjise ne rang Agjensie per vitin 2018

| AGJENSIA | Konsumi Fiderit kWh | Faturimi Fiderit kWh | Humbjet KWh | Humbjet % |
|--------------|---------------------|----------------------|-------------------|--------------|
| Berat | 126,234,792 | 103,595,427 | 22,639,365 | 17.9 |
| Kucove | 47,170,480 | 38,477,282 | 8,693,198 | 18.4 |
| Lushnje | 165,445,570 | 129,327,656 | 36,117,914 | 21.8 |
| Skrapar | 24,141,341 | 18,421,665 | 5,719,676 | 23.7 |
| Total | 362,992,183 | 289,822,030 | 73,170,153 | 20.16 |

Si vihet re dhe ne tabelat e bilancit te energjise elektrike nevoja per energji elektrike e abonenteve tane eshte ne ritje.

Më poshtë po paraqesim në forëm tabelare bilancin vjetor të energjisë elektrike për N/Stacionet ne varesi te Drejtorise Rajonale Berat për vitin 2020.

| NENSTACIONI | Konsumi N/Stacionit kWh | Faturimi N/Stacionit kWh | Humbjet KWh | Humbjet % |
|------------------------------|-------------------------|--------------------------|-------------------|-------------|
| (Lushnje)Qëndër LU V 133 | 9618538 | 7034797 | 2583741 | 26.8 |
| 110/20 Burdullias BR E 113 | 21038854 | 15359522 | 5679332 | 26.99 |
| 110/20 Uznove BR E 114 | 17784948 | 17034910 | 750038 | 4.22 |
| Bicukas | 21116511 | 16411649 | 4704862 | 22.3 |
| Bogove BR V 167 | 1049753 | 787221 | 262532 | 25 |
| Çiflig BR V 115 | 6134184 | 5069684 | 1064500 | 17.4 |
| Çorovode SK V 118 | 9909819 | 6825783 | 3084036 | 31.2 |
| Corovode e re | 2746620 | 787632 | 1958988 | 71.3 |
| Goriçan BR V 117 | 6213365 | 4823385 | 1389980 | 22.4 |
| Hysgjokaj LU V 134 | 3945752 | 2743765 | 1201987 | 30.4 |
| Kombinat BR V 112 | 17858447 | 13637934 | 4220513 | 23.6 |
| Kucove 10 kv & 6 kv | 29449567 | 27236328 | 2132868 | 9.5 |
| Mertish LU V 135 | 15094206 | 11999552 | 3094654 | 20.5 |
| Plasmasi LU E 132 (20KV) | 36426356 | 31486635 | 4939721 | 13.5 |
| Plasmasi LU E 132 (6KV) | 23001788 | 16861249 | 6140539 | 26.7 |
| Pobrat BR V 116 | 9088964 | 6020066 | 3068898 | 33.7 |
| Poliçan SK V 119 | 7114436 | 5682318 | 1432118 | 20.13 |
| Uznove BR E 114 | 4972972 | 4913835 | 59137 | 1.2 |
| Total | 416,071,000 | 345,069,000 | 71,003,000 | 17.1 |

- **Humbjet sipas fidrave dhe pesha specifike qe zene tek totali.**

Më poshtë po paraqesim në forëm tabelare bilancin vjetor të energjisë elektrike te vitit 2020 për Fiderin e perzgjeshur per te investuar ne rrjetin shperndares te TU me kabell ABC, vleresuar nga ana jone si **INVESTIM PRIORITAR**. Keto objekte (kabinat) jane vleresuar si prioritare per te investuar ne rrjetin e TU me kabell ABC pas konsultave te bera ndermjet Deges Teknikte dhe Deges se Shitjes ne Rajonin Berat dhe mbi te gjitha duke u bazuar ne opinionin e drejtuesve te Agjensive ne varesi te Rajonit Berat.

| AGJENSIA | NENSTACIONI | FIDERI | Konsumi Fiderit kWh | Faturimi Fiderit kWh | Humbjet KWh | Humbjet % |
|--------------|----------------------|--------|---------------------|----------------------|----------------|-----------|
| Berat | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | 8524854 | 4572150 | 3952704 | 46 |
| Total | | | 8524854 | 4572150 | 3952704 | 46 |

Persa i perket peshes specifike qe zene keta Fidera te totali i Humbjeve te energjise elektrike referuar shifrave te mesiperme mund te themi se humbjet ne keta Fidera zene **2.9%** te humbjeve te energjise ne Rajonin Berat.

- **Evidentimi i zonave problematike nga pikpamja e humbjeve.**

Sic shikohet nga pikpamja e humbjeve **Fideri Nr.4 (10kV)**, N/Stacioni Kucove 110/ 35/10/6KV eshte nje fider me humbje te larta te energjise elektrike dhe problemi kryesor jane linjat e tensionit te ulet.

- **Zonat problematike nga ana e mundesise se abuzimit me rrjetinTM/TU.**

Ne zonat e thella larg qyteteve aty ku linjat jane teper te gjata dhe me percjelles ajror ka me shume mundesi per abuzim me rrjetin nga ana e abonenteve. Prandaj nga ana jone eshte kerkuar dhe jane hartuar projektet e zbatimit qe te behet nje investim me rrjet ajror ABC ne menyre qe te parandalohen kete abuzime. Rrjeti TU i gjithi është i ndërtuar afër objekteve të abonenteve, në të gjithë gjatësinë e tij është me përcjellës ajror gje qe favorizon konsumatorët te abuzojne me energjine elektrike duke hedhur ganxhat ne mbremje dhe gjate nates dhe furnizojne objektet e tyre jashte matesit. Keto zona furnizohen me energji elektrike nga Fiderat e siperpermendur te cilet jane dhe Fiderat me humbje me te medha te energjise elektrike.

- **Zonat qe furnizohen me energji nga Kabinat e perzgjedhura ne Fidriat, N/Stacionet persa i perket vendndodhjes se tyre jane urbane / rurale / rurale e thelle ne territorin e Bashkise / qytetit / zones / fshatit.**

Ne tabelen e meposhtme jane pasqyruar te gjitha Kabinat e Fiderit Nr.4 (10kV), N/Stacioni Kucove 110/35/10/6KV , Agjesnia dhe zona ku ndodhen ose abonentet qe furnizojne me energji elektrike. Shihet qarte qe kemi perzgjedhur per te investuar ne zona Rurale dhe Rural te thelle, sepse jane zona ku impakti i humbjeve te energjise eshte me i madh.

| Agjensia | Nenstacioni | Fideri | Kabina | Zona ku ndodhet | Nr. Abonenteve |
|----------|-------------------------|--------|--------------|-----------------|----------------|
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Mbreshtan -2 | Rural | 91 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Mbreshtan-1 | Rural | 55 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Mbreshtan-3 | Rural | 72 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Galine -2 | Rural | 22 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Galine -1 | Rural | 73 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Paftal-4 | Rural | 25 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Paftal -1 | Rural | 22 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Sinje | Rural | 73 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Kamcisht-1 | Rural | 20 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Paftal-3 | Rural | 53 |

| | | | | | |
|--------|-------------------------|--------|--------------------|-------|-----|
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Paftal-2 | Rural | 20 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Pashalli-3 | Rural | 53 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Pashalli-1 | Rural | 32 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Konesbalt -3 | Rural | 71 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Pashalli-2 | Rural | 94 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Pashalli Industria | Rural | 95 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | SMT | Rural | 64 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Konesbalt-1 | Rural | 99 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Kamcisht-2 | Rural | 50 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Sadovec | Rural | 51 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Tapi Qender | Rural | 168 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Tapi e Madhe | Rural | 112 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | MBolan -1 | Rural | 35 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Mbolan -2 | Rural | 66 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Mbolan-3 | Rural | 29 |
| Kucove | Kucove 110/35/10/6KV | 4/10KV | Konesbalt -2 | Rural | 11 |

- **Ecuria e zhvillimit demografik te kesaj zone dhe ecuria e konsumit te energjise.**

Fideri Nr.4 (10kV), N/Stacioni Kucove 110/35/10/6 i perzgjedhur nga ana jone per te investuar duke bere rikonstrukcionin e rrjetit TU me kabell ABC ne pergjithesi eshte zone rurale ku nevoja per energji elektrike eshte ritur shume kohet e fundit sepse ne te gjitha fshatrat jane ndertuar sera perimesh te cilat kane ritur ndjeshem kerkesen per energji elektrike. Keto zona se fundmi jane populluar shume sepse dhe ndertimet kane qene te shumta kjo ka bere qe nevoja per te shtrire rrjetin elektrik aty ku jane ndertuar shtepite dhe bizneset e ndryshme te fermereve. Deri para 4 vjetesh rrjeti elektrik TU eshte ndertuar nga vete abonentet dhe ne pergjithesi eshte jashte kushteve te shfrytezimit teknik dhe sigurimit teknik. Është e qartë që për ti paraprirë nevojave për furnizimin me energji elektrike të abonenteve, duhet zhvilluar një infrastrukturë elektrike e përshtatshme, që të garantojë një shërbim cilësor kundrejt konsumatoreve aktuale dhe njëkohësisht të jetë në përputhje me zhvillimet e pritshme afatgjata të Drejtorise Rajonale Berat dhe zonave ku do implementohen projektet.

- **Viti i ndertimit te kabines dhe rrjetit TU.**

Kabinat qe jane perzgjedhur nga ana jone per rikonstrukcion rrjeti TU me kabell ABC jane te vjetra kryesisht te ndertuara ne vitet 70-80. Gjëndje aktuale e rrjetit TU të kabinave ekzistuese të Fiderit Nr.4 (10kV), N/Stacioni Kucove 110/35/10/6KV te siperpermendur është jashtë kushteve të Shfrytëzimit Teknik dhe Sigurimit Teknik dhe nuk jep siguri për furnizimi e abonentëve. Rrjeti TU i këtyre zonave është ndërtuar që në vitin 1970 në kohën e elektrifikimit të Shqipërisë dhe është tejet e amortizuar, përcjellësi në segmente të ndryshme të këtij rrjeti TU është Cu 6 mm² dhe zingato në disa raste. Gjithashtu dhe zgjatmet e ketyre linjave TU, te cilat ne shume raste jane ndertuar nga vete banoret ne kohen e tranzicionit qe kompania ka kaluar me pare jane jashte kushteve teknike. Jane perdorur bandiera vreshtash ne vend te shtyllave, jane perdorur profile hekuri ne vend te shtyllave dhe traversat TU i kane sajuar me se te mundnin duke perdorur ne vend te izolatoreve TU tubo gome (zore). Panelet e tensionit të ulet janë jashtë kushteve të Shfrytëzimit Teknik, në këto panele paisjet komutuese dhe mbrojtëse janë pothuajse jashtë funksionit të tyre. Problematikat në këto Fidera janë nga më të ndryshmet dhe me poshte po rendisim ato me kryesoret:

1. Rrjeti TU i gjithi është i ndërtuar afër objekteve të abonenteve, në të gjithë gjatësinë e tij është me përcjellës ajror. Kjo i krijon mundesine abuzuesve qe gjate nates te hedhin ganxhat ne linje dhe te furnizohen jashte matjes.
2. Përcjellësi ajror Al-16 mm² është shumë i amortizuar.
3. Një pjesë e tij është i ndërtuar nga vetë abonentët ne kohen e tranzicionit, me shtylla profil hekuri jashtë të gjitha kushteve të Shfrytëzimit Teknik dhe Sigurimit Teknik, të cilat i kemi parashikur për ti ndëruar.
4. Përcjellësi tejet i amortizuar sjell problem gati të përditëshme për punonjësit tanë, traversat janë në një pjesë të madhe të tyre të thyera të ndërtuara në një pjesë të madhe të tyre nga vete abonentët, një pjesë e izolatorëve janë të thyer dhe në disa raste janë zëvendësuar jo me izolator TU por me mjete të ndryshme jopërçuese.
5. Edhe në kampat e para të daljeve te ketyre kabinave rrjeti TU është 1 fazor, kjo ndikon negativisht në shpërndarjen e ngarkesave në transformator. Gjithashtu te keto kabina tokezimi i përsëritur mungon totalisht.

6. Ka shume kabina metalike fushore (transformatori eshte ne toke) dhe paisjet komutuese dhe mbrojtëse të tyre janë jashtë funksionit. Ndarësat TM te kabinave nuk jane funksional dhe siguresat TM janë pa fishek dhe bazamanti i thyer. Kjo ka qene dhe shkak i defekteve te shumta qe jane shfaqur ne keto kabine dhe per pasoje kjo ndikon ne gjithe Fiderin.
- **Mundesia e abuzimeve, me lidhjet ne rrjetin TU ? (opinioni i teknikes dhe i shitjes se rajonit tuaj nga historiku)**

Pjesa me e madhe e rrjetit te tensionit te ulet me shtylla dhe percjellesa ajror eshte brenda ne shtepite e abonenteve dhe ka mundesi te medha per abuzime nga abonentet. Ne zonat me sera perimesh rrjeti elektrik i TU eshte akoma me keq sepse ky rrjet eshte ndertuar ne kohen e tranzicionit nga vete konsumatorët dhe thyllat nuk jane te regullta por jane profile hekuri ose dege pemesh. Abuzimi me i madh ne keto zona eshte me linja jashte matesit (duke hedhur ganxhat ne linje) favorizuar dhe nga faktoret e siperpermendur. Ne keto zona gjate kontrolleve te kryera per parandalimin e abuzimit me energjine elektrike kemi konstatuar dhe raste te vjedhjes dhe kemi marre masat sipas ligjit. Opinioni i teknikes dhe i shitjes eshte i njejte per keto zona.

Ecuria historike e humbjeve e fiderave, zonave ne se eshte e mundur te llogaritet me bilancieret si dhe pesha specifike qe ze kjo humbje tek totali ??

Ne mungese te matesave te Bilancit ecuria e humbjeve per cdo kabine ne Fiderin Nr.4 (10kV), N/Stacioni Kucove 110/35/10KV i perzgjedhur per rikonstrukcionin e rrjetit TU me kabell ABC eshte bere me matesin e bilancit ne Fider/Nenstacion.

Ne totalin e humbjeve te energjise elektrike kabinat e perzgjedhura si Prioritare per investim ne rrjetin TU me kabell ABC, keto Fidera zene **2.9%** te totalit te humbjeve te energjise elektrike ne Rajon.

- **Si jane faturimet ne keto zona.**

Faturimi ne te gjitha kabinat e perzgjedhura si Prioritare per te investuar duke kryer rikonstrukcionin e rrjetit te Tensionit te Ulet me kabell ABC kryhet i rregullt dhe pa probleme nga lexuesi i Agjensis ne varesi te Rajonit Berat dhe 65% e leximeve shoqerohen me foto te qarte te matesit.

- **Ecuria e konsumit?**

Konsumi ka ardhur ne rritje dhe brenda kufijve te ngarkesave nominale te Çelesave te Fiderave ne N/Stacionet qe furnizojne me energji elektrike zonat e perzgjedhura per te investuar ne rrjetin TU me kabell ABC si dhe brenda kufijve nominal te Transformatoreve te fuqise ne keto N/Stacione. Kjo vihet re duke krahasuar konsumin vjetor te energjise elektrike ne Rajonin Berat per vitin 2019 me vitin 2020.

Pra konsumi energjise elektrike ne vitin 2019 ne Rajonin Berat ka qene **3,57,490,125 kWh** ndersa ne vitin 2020 konsumi energjise elektrike ka qene **416,071,000 kWh**

Ndersa faturimi i energjise elektrike ne vitin 2019 ne Rajonin Berat ka qene **289,822,030 kWh** kurse ne vitin 2020 faturimi energjise elektrike ka qene **345,069,000kWh**.

- **Treguesit e cilesise se furnizimit nivele tensioni , SAIDI, SAIFI i fidrit (numri i nderprerjeve dhe kohezgjatje e riparimit) dhe si ndikon kjo kabine ne numrin e nderprerjeve, provokimin e stakimeve te fidrit, nderprerje per shkak te gjendjes teknike apo mbingarkesa te shkaktuara nga abuzimet.**

Në Fiderin Nr.4 (10kV), N/Stacioni Kucove 110/35/10/6KV i perzgjedhur per te kryer investim duke bere rikonstrukcionin e rrjetit TU me kabell ABC mesatarja mujore e difekteve të ndodhura në TM është 3 difekte dhe kohëzgjatja e riparimit të difektit është 3 orë. Ndërsa për difektet e ndodhura në TU mesatarja mujore është 15 difekte dhe kohëzgjatja e riparimit të difektit është 1.5 orë.

Për difektet e ndodhura në TM numri abonentëve që ngelen pa energji elektrike është 1600 abonent, ndërsa për difektet në TU numri abonentëve 90 (mesatarja e abonentëve për kabinë).

Me përfundimin e investimit, pra me rikonstrukcionin total të rrjetit TU dhe kthimin e tij ne kabllor ABC do të kemi një përmirësim total të treguesve të cilësis SAIFI & SAIDI.

- **Cilesisa e furnizimit te rrjetit TU dhe kabines nderprerje dhe difekte, nivele tensioni .**

Rrjeti TU i gjithi është i ndërtuar afër objekteve të abonentëve, në të gjithë gjatësinë e tij është me përcjellës ajror. Kjo i krijon mundesine abuzuesve qe gjate nates te hedhin ganxhat ne linje dhe te furnizohen jashte matjes. Përcjellësi ajror Al-16 mm² është shumë i amortizuar. Përcjellesi tejet i amortizuar sjell problem gati të përditëshme për punonjësit tanë, traversat janë në një pjesë të madhe të tyre të thyera të ndërtuara në një pjesë të madhe të tyre nga vete abonentët, një pjesë e izolatorëve janë të thyer dhe në disa raste janë zëvendësuar jo me izolator TU por me mjete të ndryshme jopërcuese.

Ne keto zona ankesat per nivel tensioni jane te shumta je vetem per arsyet e mesiperme qe kane te bejne me seksionin e percjellesave dhe vetite e tyre percuese por dhe per shkak te ritjes se ngarkeses ne menyre artificial nga abonentet e papergjegjshem te cilet abuzojne me nergjine elektrike. Kjo behet dhe shkak-arsyeja e difekteve te shumta ne TU. (keputje percjellesi, Ckycje automati si pasoje e mbingarkeses dhe Lidhjeve te Shkurtra).

Ka shume kabina metalike fushore (transformatori eshte ne toke) dhe paisjet komutuese dhe mbrojtëse të tyre janë jashtë funksionit. Ndarësat TM te kabinave nuk jane funksional dhe siguresat TM janë pa fishek dhe bazamanti i thyer. Kjo ka qene dhe shkak i defekteve te shumta qe jane shfaqur ne keto kabine dhe per pasoje kjo ndikon ne gjithe Fiderin.

- **Rregjimi i punes se kabines ? (simetrizimi i ngarkesave)**

Edhe në kampatat e para të daljeve te ketyre kabinave rrjeti TU është 1 fazor, kjo ndikon negativisht në shpërndarjen e ngarkesave në transformator. Para guke patur nje asimetri te madhe ne keto kabina transformoret nuk punojne ne rregjim normal duke ritur humbjet ne transformator dhe ne rastin me te keq demtimin e transformatorit. Me ndertimin e rrjetit TU me kabell ABC te kabinat e perzgjedhura si prioritare do te arijme ne simetrizimin e ngarkesave e cila ndikon ne uljen e humbjeve teknike dhe transformoret do te punojne ne rregjim normal.

Gjithashtu ne shumicen e ketyre kabinave tokezimi i përsëritur mungon totalisht.

- **Gjendja teknike e kabinave e mire/ mesatare/ e keqe.**

Ne pergjithesi gjendja e tyre paraqitet mesatare sepse kemi kabina ne te cilat paisjet mbrojtese dhe komutuese ne Tension te Mesem jane jashte funksionit te tyre. Ne pergjithesi Panelet TU te kabinave te perzgjedhura per te investuar me kabell ABC jane ne gjende te keqe.

- **Gjendja ndertimore e kabinave**

Ne pergjithesi gjendja e tyre paraqitet mesatare dhe e keqe sepse nje pjese e madhe e kabinave murature me mur guri jane ne rezik shembje dhe te gjitha kabinat qe ne metalike paraqesin rezikshemri nga pikepamja e Sigurimit Terknik dhe Shfrytezimit Teknik.

- **Gjendja teknike e rrjetit TU, shtylla, percjellesa.**

Gjendje aktuale e rrjetit TU të kabinave ekzistuese të Fiderit Nr.4 (10kV), N/Stacioni Kucove 110/35/10/6KV te siperpermendur është jashtë kushteve të Shfrytëzimit Teknik dhe Sigurimit Teknik dhe nuk jep siguri për furnizimi e abonentëve. Rrjeti TU i këtyre zonave është ndërtuar që në vitin 1970 në kohën e elektrifikimit të Shqipërisë dhe është tejet e amortizuar, përcjellësi në segmente të ndryshme të këtij rrjeti TU është Cu 6 mm² dhe zingato në disa raste. Gjithashtu dhe zgjatmet e ketyre linjave TU, te cilat ne shume raste jane ndertuar nga vete banoret ne kohen e tranzicionit qe kompania ka kaluar me pare jane jashte kushteve teknike. Jane perdorur bandiera vreshtash ne vend te shtyllave, jane perdorur profile hekuri ne vend te shtyllave dhe traversat TU i kane sajuar me te te mundnin duke perdorur ne vend te izolatoreve TU tubo gome (zore).

Panelet e tensionit të ulet janë jashtë kushteve të Shfrytëzimit Teknik, në këto panele paisjet komutuese dhe mbrojtëse janë pothuajse jashtë funksionit të tyre.

- **Gjendja e daljeve per tek abonenti.**

Kryesisht te gjitha daljet nga kabina te shtyllat e para do te realizohen te reja me kabell XLPE ne toke dhe me mbrojtese metalike ne ngjitjen e shtylles sipas standarteve te kompanise. Kjo do te kryhet ne ato kabina ne te cilat daljet e para jane jashte kushteve teknike. Gjithashtu do te vendoset kabell Cu Koaksial nga pika e lidhjes deri ne matesin e abonentit sepse ka shume abonent qe kabllin e furnizimit nuk e kane te regullt dhe krijon mundesi per te abuzuar me energjine elektrike.

- **Ne zonen ku do te investohet te behet vleresimi i qendres se ngarkeses dhe te behen propozime me percaktimin e kesaj qendre si dhe impaktin qe do te jape:**

Nepermjet ketij investim Drejtoria Rajonale Berat synon te arrij:

- Ne uljen e humbjeve teknike
- Permiresimin e nivelit te tensionit
- Uljen e vleres se investimit

- Rritjen e shkallës së sigurisë së furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve, për faktin se rrjeti ekzistues 0.4 kV është teper i amortizuar dhe me shumë defekte.
- Zëvendësimin e linjave TU ekzistuese të cilat janë jashtë kushteve teknike si dhe zëvendësimin e paneleve TU në mënyrë që të kryejnë funksionin e tyre kryesor (mbrojtës, komutues dhe matës).
- Përmirësimi i treguesve të cilësisë SAIFI & SAIDI.
- Rritjen e Sigurisë në Pune të punonjësve tane që shfrytëzojnë këto rrjet por dhe të përdoruesve të këtij rrjeti (abonentet).

• **Permiresimi i cilesise se furnizimit (tensionit, numrit te nderprerjeve, kohezgjatjes se riparimit)**

Avantazhet e rrjetit shperndares 0.4 kV me kablllo me vetembajtje ABC kundrejt atij me percjellesa te zhveshur tashme jane te ditura dhe konkretisht themi:

- Ne uljen e humbjeve teknike
- Permiresimin e nivelit te tensionit
- Rritjen e shkallës së sigurisë së furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve, për faktin se rrjeti ekzistues 0.4 kV është teper i amortizuar dhe me shumë defekte.
- Zëvendësimin e linjave TU ekzistuese të cilat janë jashtë kushteve teknike si dhe zëvendësimin e paneleve TU në mënyrë që të kryejnë funksionin e tyre kryesor (mbrojtës, komutues dhe matës).
- Përmirësimi i treguesve të cilësisë SAIFI & SAIDI.
- Rritjen e Sigurisë në Pune të punonjësve tane që shfrytëzojnë këto rrjet por dhe të përdoruesve të këtij rrjeti (abonentet).
- Uljen e ndikimeve negative në mjedis

• **Afati kohor i shlyerjes se investimit**

Per shlyerjen e investimit koha ne vjet eshte 6 vjet duke marre ne konsiderate perfitimet qe ka kompania nga reduktimi i humbjeve te energjise, por duke marre ne konsiderate dhe faktor te tjere qe ndikojne si p.sh. minimalisht per 6 vjet nuk do perdoret baze materiale per remonte ose riparim avarie ne zonen ku do te investohe dhe kostot e tjera(fuqi punetore, mjete levizese etj). Por duke marre vleren totale te preventivave e cila eshte **114,168,136 Leke** dhe vleren ne Leke te energjise se kursyer nga ulja e humbjeve teknike dhe joteknike e cila eshte **675,083 Leke** dhe vleren ne Leke te kursyera nga reduktimi i shpenzimeve operative te siperpermendura atehere jemi ne gjendje te themi se afati kohor i shlyerje se ketij investimi eshte **6 Vjet** nga perfundimi i investimit.

• **Vleresimi sipas pikezimit ne perputhje me metodologjise se pikezimit ne permbledhese te bashklidhur te ndertuar mbi baze Rajoni -N/stacioni –Fideri teper e rendesishme**

Ne perputhje me metodologjine e pikezimit lidhur me objektivat qe plotesojne keto projekte dhe qellimin e realizimit te tyre nga ana jone eshte bere vleresimi sipas pikeve per secilin objekt investimi, i cili eshte i ndertuar ne baze Kabine, Fideri dhe N/Stacioni.

Bashkelidhur ketij Relacioni – Teknik eshte dhe tabela e pikezimit per keto investime.

- **Projekt-preventivi i investimit sipas standarteve te OSHEE-se.
HARTIMI I PROJEKTEVE**

1. Hartimin e projekt-zbatimit për linjat TU 0.4 kV. Rrjeti TU me kablllo me vetembajtje ABC konform standarteve te OSHEE sh.a.
2. Llogaritja e rrymave per ngarkese nominale duhet te jete brenda normave te lejuara.
3. Shkalla e projektit të zbatimit të linjës T.U do të jetë 1:1000 deri maksimumi 1:2000.
4. Projekti duhet të jetë në përputhje me kushtet teknike të projektimit. (shënimet teknike, profile prerjesh të ndryshme, detaje etj.)
5. Projekti duhet të ketë të gjitha skemat elektrike përkatëse.
6. Projekti do të shoqërohet me një relacion teknik ku të jenë llogaritur humbjet e energjisë Bashkëngjitur projekti të shoqërohet me dokumentacionin për standartizimet teknike të materialeve të caktuara për tu përdorur.
7. Projekti do te dorezohet ne 3 kopje.

HARTIMI I PREVENTIVAVE.

1. Preventivat jane hartuar sipas VKM Nr. 629 date 15.07.2015.
2. Analizat teknike qe nuk jane ne VKM Nr. 568 jane hartuar sipas librit Nr. 6 " Montimi i linjave dhe te n/stacioneve " si dhe te atij te " Normave komunale" sipas udhezimit Nr.2 date 08.05.2003 ne mbeshetje te ligjit Nr.8402 date 10.09.1998.
3. Ne analizat teknike sigurimet shoqerore qe paguhen nga punedhenesi jane marre 16.7 % ne zbatim te VKM Nr.414 date 27.06.2012. Paga orare eshte marre 185 Leke sipas VKM 629 date 15.07.2015
4. Ne kete preventiv nuk do llogariten vlerat per mbikqyrje, kolaudim dhe leje ndertimi.
5. Çmimet e bazes materiale jane marre ne Drejtorine ekonomike te OSHEE (SAP - i) date 03.02.2015
6. Volumet e germimeve, betonimeve dhe te montimeve te merren sipas standarteve te OSHEE , bashkengjitur projektit.
7. Dherat e hequr nga kanali ne rruge te asfaltuara do te largohen deri ne distance 10 km.
8. Per pumimet e ndertimit e te montimit ne baze te udhezimit Nr. 2 te date 08.05.2003 te VKM Nr. 8402 date 10.09.1998 te merret shtesa 50 % mbi page.
9. Shpenzimet plotesuese jane 8 % sipas VKM Nr. 568 date 27.06.2013.
10. Norma e fitimit eshte 10 % sipas VKM Nr. 568 date 27.06.2013.
11. Numri i konsumatoreve qe jane ne kete kabine do te saktësohet ne degen e shitjes se Drejtorise, do te lidhen vetem ato qe kane kontrate me Drejtorine Rajonale elbasan
12. Gjatesia e kabllit koaksial CU - 1x6/6 mm² te merret 30 ml per abonent

Punoi: